




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranim / Dorezuar Priljeno / Predato Received / Delivery	08.08.2022	viti god. year	
Organ / Shesa Organ / Jednica Org / Unit	Hr Prot Br Prot Prot No	Shojra Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/SHM	4605/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.629/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.629/2022 të datës 18.07.2022 të parashtruar nga ankuesja nga Prishtina, kundër heshtjes administrative të Komisionit për Shtesa të Teknologjisë Informative të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.629/2022 e datës 18.07.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, më datë 18.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4169/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtje administrative të Komisionit për Shtesa të Teknologjisë Informative të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa më datë 22.07.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova:



Ankesën me numër protokoli 4169/2022 të datës 18.07.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për aprovim të shtesës e datës 20.05.2022 nga ankuesja për Komisionit për Shtesa të TI-së në MPB; Akt Emërimit e datës 20.08.2018 të ankueses; Vendimin me Nr.322 të datës 06.02.2019 të Komisionit për shtesa të fushës së Teknologjisë Informativë dhe Inxhinieringut; Diplomën me Nr.2011/21 të datës 15.07.2021 dhe Nr.282 të datës 15.02.2011 të ankueses; Certifikatën e datës 09.12.2019; Certifikatën për periudhën 19.04.2021-30.04.2021; Certifikatën për periudhën 10.05.2021-21.05.2021; Certifikatën e datës 12.04.2021; Certifikatën maj 2005; Certifikatën për periudhë 04-08.07.2005; Vendimin me Nr. 02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Kosovës së bashku me Aneksi I; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 21.07.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 22.07.2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Analiste e Teknologjisë Informativë për Sisteme i datës 16.08.2018; Vendimin me Nr. 07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Kosovës; Listën e pagave për ankuesen.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së është e **pabazuar** ankesa e ankueses, **SEPSE**:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesja në bazë të Akt Emërimit të datës 20.08.2018 është e punësuar në pozitën *Analiste e Teknologjisë Informativë për Sisteme* në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Me Vendimin me numër protokoli 322 të datës 06.02.2019, Komisioni për Shqyrtimin e shtesave të fushës së teknologjisë informative dhe inxhinieringut i themeluar sipas Vendimit me nr.222/2018 të datës 05.11.2018, ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Financave duke i njohur ankueses shtesën në paga prej 200 euro, ndërsa ankuesja serish me datë 20.05.2022 ka parashtruar kërkesë pranë këtij komisioni për njohjen e të drejtës për shtesë në pagën bazë në vlerën 400 Euro dhe në mënyrë retroaktive shumë prej 200 Euro nga data 09.02.2019. Pasi ankuesja nuk pranon përgjigje nga Komisioni për Shtesa të Teknologjisë Informativë në Ministrinë e Punëve të Brendshme e njëjta parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin së bazuar në Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës i takon shtesa mbi pagën bazë në vlerën 400 Euro, duke kërkuar që në mënyrë retroaktive t'i bëhet kompensimi prej 200 Euro nga data 09.02.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, ka analizuar Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar lista e pozitive dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informativë dhe inxhinieringut, ku sipas të njëjtit zbatimi i aneksit I duhet të bëhet në pajtim me Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Me Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është përcaktuar procedura për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave dhe mënyra e realizimit të shtesave për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare, dhe rrjedhimisht është konstatuar se aprovimi i shtesave në pagë për pozita deficitare është bërë me qëllim të ruajtjes së kategorive të veçanta deficitare të punonjësve, stimulimit të konkurrimit për profesione të veçanta deficitare dhe zbatimit të parimit të pagesës së njëjtë për punë të njëjtë në të gjitha organizatat buxhetore. Po ashtu, me këtë vendim është përcaktuar se paga bazë së bashku me shtesat mbi pagë nuk mund të tejkalojnë pagën e zyrtarëve të lartë të emëruar nga KELP-i, si dhe është obliguar Ministria përgjegjëse për

Administratë Publike dhe Ministria e Financave për shqyrtimin e listës dhe standardëve kualifikuese dhe shumës stimuluese për postet e caktuara, së paku një herë në gjatë muaj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: 1. *Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut.* Përkitazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë.

Me hyrjen në fuqi të Rregullosës Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Vendimi Nr.07/29 i datës 31.07.2008 dhe Vendimi Nr.02/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, konstatim ky i dhënë edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që mbi këto arsye dhe duke pas parasysh së Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka nxjerr vendim të ri lidhur me shtesat për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankueses për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në dispozitat e Rregullosës Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 të kësaj rregullore, ka arritur të konstatojë se ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut për pozitave ose llojet e pozitave për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40% më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitave në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut duhet t'i ofroje ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën lidhur me arsyeshmërinë e realizimit të shtesës dhe një analizë që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, listën e pozitave përkatëse dhe koston vjetore të vlerësimit financiar. Shtesa mbi pagën bazë për kushte të veçanta të tregut nuk mund të tejkalojë më shumë se 50% të pagës bazë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.629/2022

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

